



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHËNDETËSISË - MINISTARSTVO ZDRAVLJA - MINISTRY OF HEALTH	
Njesia Org. Org. Jedinica Org Unit	01
Nr. Prot. Broj Prot. Prot No:	05-9997
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	-10-
Data: Datum: Date:	20/12/2024
Prishtinë / a	

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
**Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravstva / Ministry of Health**  
**Zyra e Ministrit / Ured Ministra / Office of the Minister**

**Nr.207/XII/2024**

**Datë:20.12.2024**

Ministri i Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 145, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në përputhje me nenet 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr. 7, 01 Mars 2019), nenit 11 paragrafi 1.5 i Ligjit nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive Shtojca 1 paragrafi 6 nën paragrafi 6.1, bazuar në paragrafin 1 të nenit 16 të Udhëzimit Administrativ (shëndetësi) 01/2023 për Shkollimin Specialistik, në bazë të rekomandimit të Bordit për Shkollim Specialistik nr. 05/9943 me datë 19.12.2024 nxjerrë këtë:

**V E N D I M**

- I. Aprovohet rekomandimi i Bordit për Shkollim Specialistik për shpalljen e konkursit për shkollim specialistik.
- II. Pjesë e këtij vendimi është konkursi për shkollim specialistik me kriteret sipas rekomandimit nga Bordi për Shkollim Specialistik nr. 05/9943 me datë 19.12.2024
- III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Vendimi i dërgohet:**

- Zëvendësministrave;
- Sekretarit të përgjithshëm;
- DZHSSH;
- Departamentit Ligjor;
- Arkivot të MSh-së;

**Dr.Arben Vitia**  
**Ministër i Shëndetësisë**





REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH			
Njësia Org. Org. Jedinica Org Unit	06	Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	05-9943
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	-9-	Data: Datum: Date:	19/12/2024
		Prishtinë / a	

Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstva Zdravstva - Ministry of Health  
Bordi për Shkollim Specialistik/ Odbor za Specialističko Školovalnje/ Board for Specialistic Education

<b>PËR/ZA/TO:</b>	Dr. Arben Vitia, Ministër i Shëndetësisë		
<b>CC:</b>	Dr. Naim Bardiqi, Sekretar i Përgjithshëm		
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Ass. Edmond Haliti, MD, FESC, Kryesues i BShS		
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	REKOMANDIM për konkurs të shkollim specialistik		
<b>Nr. i zyrës:</b>	<b>Lokacioni:</b>	<b>Data:</b>	19.12.2024
<b>Br. kancelarije:</b>	<b>Kucni:</b>	<b>Datum:</b>	
<b>Room No.:</b>	<b>Extension:</b>	<b>Date:</b>	
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION			<input type="checkbox"/>
PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL			<input type="checkbox"/>
PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/FOR SIGNATURE			<input type="checkbox"/>
PËR KOMENTE/ZA KOMENTARE/FOR COMMENTS			<input type="checkbox"/>
A MUND TË DISKUTOJMË/DALI MOZEMO RASPRAVLJATI/MAY ËE DISCUSS			<input type="checkbox"/>
VËMENDJA JUAJ/VASA PAZNJA/YOUR ATTENTION			<input type="checkbox"/>
SIPAS DISKUTIMIT/KAKOJE RASPRAVLJENO/AS DISCUSSED			<input type="checkbox"/>
SIÇ ËSHTË KËRKUAR/KAKO JE ZATRAZENO/AS REQUESTED			<input type="checkbox"/>
SHËNIM DHE PËRGJIGJE/BELESKA I ODGOVOR/NOTE AND RETURN			<input type="checkbox"/>
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION			<input type="checkbox"/>
<b>AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE</b>			

Të nderuar,

Në pajtim me **Ligjin për Shëndetësi Nr. 04/L-125** dhe **Udhëzimin Administrativ mbi shkollimin specialistik Nr.01/2023** (neni 16, 17, 18), Bordi për Shkollim Specialistik (BShS) në përputhje me kompetencat e tij, pas pranimit të kërkesave nga institucionet shëndetësore, e më tej në bazë të analizës së nevojave e prioriteteve në nivel vendi, në raport me kapacitetet mentoriale e infrastrukurore për organizimin dhe mbarëvajtjen e shkollimit specialistik, i rekomandon Ministrin të Shëndetësisë, shpalljen e konkursit për shkollim specialistik për doktorët e mjekësisë (MD), doktorët e stomatologjisë (Dr Dent), magjistrat e farmacisë (Mr Ph) në lëmitë specialistike, përkatësisht institucionet kërkuese të mëposhtme, specifikuar më poshtë:

**Kategoria I:** Institucionet publike shëndetësore të nivelit sekondar dhe terciar sipas kërkesave të tyre, respektivisht lëmive prioritare bazuar në nevoja, të financuara nga buxheti i shtetit:

<b>Lëmia specialistike</b>	<b>Titulli paraprak</b>	<b>Institucioni</b>	<b>Numri i vendeve</b>	<b>Arsyetimi</b>
Mjekësi Emergjente	MD	SHSKUK	Total 11, sipas shpërndarjes: SP Peje 2, SP Gjilan 1 , SP Prizren 2, SP Mitrovice 2, SP Ferizaj 2, SP Vushtri 2	Ka kërkesa të institucioneve, nevoja objektive si dhe kapacitete mentoriale e infrastrukture
Anesteziologji me Mjekim Intenziv	MD	SHSKUK	Total 5 sipas shpërndarjes: SP Mitrovice 1, SP Vushtri 1, SP Prizren 2, SP Gjilan 1	Ka kërkesa të institucioneve, nevoja objektive si dhe kapacitete mentoriale e infrastrukture
Mjekësi Interne	MD	SHSKUK	Total 6, sipas shpërndarjes: SP Gjakove 2, SP Gjilan 1, SP Ferizaj 2, SP Vushtri 1.	Ka kërkesa të institucioneve, nevoja objektive si dhe kapacitete mentoriale e infrastrukture
Nefrologji	MD	SHSKUK	Total 4, sipas shpërndarjes: QKUK 1, SP Peje 1, SP Gjakove 2	Ka kërkesa të institucioneve, nevoja objektive si dhe kapacitete mentoriale e infrastrukture
Pediatri	MD	SHSKUK	Total 4, sipas shpërndarjes: SP Peje 2, SP Mitrovice 1, SP Vushtri 1.	Ka kërkesa të institucioneve, nevoja objektive si dhe kapacitete mentoriale e infrastrukture
ORL	MD	SHSKUK	Total 2, sipas shpërndarjes: SP Peje 1, SP Gjilan 1	Ka kërkesa të institucioneve, nevoja objektive si dhe kapacitete mentoriale e infrastrukture
Oftalmologji	MD	SHSKUK	Total 1, sipas shpërndarjes: SP Peje 1.	Ka kërkesa të institucioneve, nevoja objektive si dhe kapacitete mentoriale e infrastrukture
Kirurgji e përgjithshme	MD	SHSKUK licencuar	Total 3, sipas shpërndarjes: SP Gjilan 1, SP Ferizaj 1, SP Mitrovice 1	Ka kërkesa të institucioneve, nevoja objektive si dhe kapacitete mentoriale e infrastrukture
Kardiokirurgji	MD	SHSKUK	Total 1, sipas	Ka kërkesa të

			shpërndarjes: QKUK-1	institucioneve, nevoja objektive si dhe kapacitete mentoriale e infrastrukturore
Radiologji	MD	SHSKUK	Total 6, sipas shpërndarjes: SP Peje 2, SP Gjakove 1, SP Ferizaj 1, SP Mitrovica 1, SP Vushtrri 1.	Ka kërkesa të institucioneve, nevoja objektive si dhe kapacitete mentoriale e infrastrukturore
Sëmundje ngjitëse	MD	SHSKUK	Total 3, sipas shpërndarjes: SP Ferizaj 1, SP Prizren 1, SP Mitrovica 1	Ka kërkesa të institucioneve, nevoja objektive si dhe kapacitete mentoriale e infrastrukturore
Onkologji Mjekësore	MD	SHSKUK	Total 1, SP Prizren 1.	Ka kërkesa të institucioneve, nevoja objektive si dhe kapacitete mentoriale e infrastrukturore
Mjekësi Nukleare	MD	SHSKUK	Total 2, sipas shpërndarjes: QKUK 2	Ka kërkesa të institucioneve, nevoja objektive si dhe kapacitete mentoriale e infrastrukturore
Mjekësi e sportit	MD	SHSKUK	Total 2, sipas shpërndarjes: QKUK 2	Ka kërkesa të institucioneve dhe ka kapacitetet mentoriale e infrastrukturore
Gjinekologji me Obstetrikë	MD	SHSKUK	Total 4, sipas shpërndarjes: SP Prizren 1, SP Gjakove 2, SP Gjilan 1.	Ka kërkesa të institucioneve, nevoja objektive si dhe kapacitete mentoriale e infrastrukturore
Neurologji	MD	SHSKUK	Total 2, sipas shpërndarjes: SP Prizren 1, SP Mitrovica 1.	Ka kërkesa të institucioneve, nevoja objektive si dhe kapacitete mentoriale e infrastrukturore
Psikiatri	MD	SHSKUK	Total 2, sipas shpërndarjes: SP Prizren 1, SP Gjakove 1.	Ka kërkesa të institucioneve, nevoja objektive si dhe kapacitete mentoriale e infrastrukturore
Urologji	MD	SHSKUK	Total 4, sipas shpërndarjes: QKUK 1	Ka kërkesa të institucioneve, nevoja objektive si

			SP Prizren 1, SP Gjilan 1, SP Mitrovice 1.	dhe kapacitete mentoriale e infrastrukturore
Fiziatri	MD	SHSKUK	Total 1, sipas shpërndarjes: SP Gjakove 1.	Ka kërkesa të institucioneve, nevoja objektive si dhe kapacitete mentoriale e infrastrukturore
Biokimi Klinike	MD	SHSKUK	Total 2, sipas shpërndarjes: SP Ferizaj 1, SP Vushtrri 1.	Ka kërkesa të institucioneve, nevoja objektive si dhe kapacitete mentoriale e infrastrukturore
Ortopedi	MD	SHSKUK	Total 2, sipas shpërndarjes: SP Peje 1, SP Mitrovice 1.	Ka kërkesa të institucioneve, nevoja objektive si dhe kapacitete mentoriale e infrastrukturore
Pulmologji	MD	SHSKUK	Total 5, sipas shpërndarjes: SP Peje 1, SP Prizren 1, SP Gjilan 1, SP Mitrovice 1, SP Vushtrri 1.	Ka kërkesa të institucioneve, nevoja objektive si dhe kapacitete mentoriale e infrastrukturore
Kirurgji torakale	MD	SHSKUK	Total 1, sipas shpërndarjes: QKUK 1.	Ka kërkesa të institucioneve, nevoja objektive si dhe kapacitete mentoriale e infrastrukturore
Kirurgji vaskulare	MD	SHSKUK	Total 2, sipas shpërndarjes: QKUK 2.	Ka kërkesa të institucioneve, nevoja objektive si dhe kapacitete mentoriale e infrastrukturore
Paradontologji dhe mjekësi orale	Dr dent	SHSKUK	Total 4, sipas shpërndarjes: QSKUK 4.	Ka kërkesa të institucioneve, nevoja objektive si dhe kapacitete mentoriale e infrastrukturore
Sëmundje e dhembit me endodoncion	Dr dent	SHSKUK	Total 5, sipas shpërndarjes: QSKUK 5.	Ka kërkesa të institucioneve, nevoja objektive si dhe kapacitete mentoriale e infrastrukturore
Protetike stomatologjike	Dr dent	SHSKUK	Total 5, sipas shpërndarjes: QSKUK 5.	Ka kërkesa të institucioneve, nevoja objektive si

				dhe kapacitete mentoriale e infrastrukture
Kirurgji orale	Dr dent	SHSKUK	Total 5, sipas shpërndarjes: QSKUK 5.	Ka kërkesa të institucioneve, nevoja objektive si dhe kapacitete mentoriale e infrastrukture
Ortodonci	Dr Dent	SHSKUK	Total 5, sipas shpërndarjes: QSKUK 5.	Ka kërkesa të institucioneve, nevoja objektive si dhe kapacitete mentoriale e infrastrukture
Transfuziologji	MD	QKTGJK	Total 4, sipas shpërndarjes: QKTGJK Prishtine 1, QT Peje 1, QT Prizren 1, QT Gjilan 1.	Ka kërkesa të institucioneve, nevoja objektive si dhe kapacitete mentoriale e infrastrukture
Epidemiologji	MD	IKSHPK	Total 5, sipas shpërndarjes: IKSHPK Prishtine 3, QRSHP Gjakove 1, QRSHP Mitrovice 1.	Ka kërkesa të institucioneve, nevoja objektive si dhe kapacitete mentoriale e infrastrukture
Shëndet publik	MD	IKSHPK	Total 6, sipas shpërndarjes: IKSHPK Prishtine 2, QRSHP Peje 1, QRSHP Prizren 1, QRSHP Gjakove 1, QRSHP Gjilan 1.	Ka kërkesa të institucioneve, nevoja objektive si dhe kapacitete mentoriale e infrastrukture
Statistikë mjekësore dhe informatikë	MD	IKSHPK	Total 3, sipas shpërndarjes: IKSHPK Prishtine 3.	Ka kërkesa të institucioneve, nevoja objektive si dhe kapacitete mentoriale e infrastrukture
Mikrobiologji klinike	MD	IKSHPK	Total 1, sipas shpërndarjes: QRSHP Mitrovice 1.	Ka kërkesa të institucioneve, nevoja objektive si dhe kapacitete mentoriale e infrastrukture

**Kategoria II:** Institucionet publike shëndetësore të nivelit primar (KPSH) sipas kërkesave të tyre, respektivisht lëmive prioritare bazuar në nevoja, të financuar nga buxheti i komunave:

Lëmia specialistike	Titulli paraprak	Institucioni	Numri i vendeve	Arsyetimi
Mjekësi familjare	MD	QKMF	Total 129, sipas shpërndarjes komunale: Prishtina 10,	Ka kërkesa të institucioneve, nevoja objektive si dhe kapacitete

			Prizreni 8 Peja 12, Gjakova 14, Gjilani 6, Ferizaj 10, Mitrovica e jugut 3, Vushtrri 2, Podujeva 2, Klina 8, Istogu 5, Lipjani 5, Suhareka 5, Glogovci 6, Skenderaj 4, Dragash 2, Obiliq 3, Malisheve 4, Rahovec 8, Kamenice 19, Mamushe 2.	mentoriale e infrastrukturore
Radiologji	MD	QKMF	Total 10, sipas shpërndarjes komunale: Prishtina 2, Prizren 1, Gjilan 1, Ferizaj 1, Podujeva 1, Istog 1, Skenderaj 1, Obiliq 1, Mamushe 1.	Ka kërkesa të institucioneve, nevoja objektive si dhe kapacitete mentoriale e infrastrukturore
Biokimi Klinike	MD	QKMF	Total 6, sipas shpërndarjes komunale: Prishtina 2, Prizreni 1, Ferizaj 1, Skenderaj 1, Dragash 1.	Ka kërkesa të institucioneve, nevoja objektive si dhe kapacitete mentoriale e infrastrukturore
Gjinekologji me obstetrike	MD	QKMF	Total 1, sipas shpërndarjes komunale: Glogovc 1.	Ka kërkesa të institucioneve, nevoja objektive si dhe kapacitete mentoriale e infrastrukturore
Pediatri	MD	QKMF	Total 2, sipas shpërndarjes komunale: Skenderaj 1, Dragash 1.	Ka kërkesa të institucioneve, nevoja objektive si dhe kapacitete mentoriale e infrastrukturore

**Kategoria III:** Institucionet publike shëndetësore sipas kërkesave të tyre, bazuar në nevojat dhe kapacitetet e brendshme, të financuara nga buxheti i vet këtyre institucioneve, respektivisht buxheti i shtetit:

<b>Lëmia specialistike</b>	<b>Titulli paraprak</b>	<b>Institucioni</b>	<b>Numri i vendeve</b>	<b>Arsyetimi</b>
Psikiatri	MD	Drejtoria shendetesore e burgjeve	Total: 1	Ka kërkesa të institucioneve, nevoja objektive si dhe kapacitete mentoriale e infrastrukture
Farmacit Klinike	Mr Ph	SHSKUK	Total 2, sipas shpërndarjes QKUK 2	Ka kërkesa të institucioneve, nevoja objektive si dhe kapacitete mentoriale e infrastrukture
Toksikologji kimike	MD	SHSKUK	Total 2, sipas shpërndarjes QKUK 2	Ka kërkesa të institucioneve, nevoja objektive si dhe kapacitete mentoriale e infrastrukture

**Kushtet e aplikimit për shkollim specialistik:**

1. Të ketë përfunduar studimet universitare (niveli bachelor dhe master ose studimet e integruara që përfshijnë këto dy nivele) në drejtimet: Mjekësi e Përgjithshme, Stomatologji, Farmaci ose Psikologji Klinike, sipas nenit 18, paragrafët 1.1, 1.2 dhe 1.3 të UA për Shkollim specialistik 01/2023;
2. Të kenë licencë pune nga fusha profesionale përkatëse;
3. Të ketë së paku një vit përvojë pune profesionale.
4. Aplikantët kanë të drejtë aplikimi në njërin nga drejtimet specialistike të shpallura në këtë konkurs, sipas drejtimeve respektive dhe lëmive specialistike përkatëse të specifikuara në shtojcën 2 të UA për Shkollim specialistik 01/2023.
5. Të ketë aftësi psiko-fizike për zbatimin e shkollimit specialistik, sipas nenit 18, paragrafi 1.6 i UA për Shkollim Specialistik 01/2023;
6. Aplikanti në lëmitë specialistike kirurgjike në ditën e aplikimit duhet të mos ketë më shumë se 40 vjeç, sipas nenit 18, paragrafi 1.7 i UA për Shkollim Specialistik 01/2023;
7. Të jetë anëtar i Odës përkatëse të Profesionistëve Shëndetësor, sipas nenit 18, paragrafi 1.8 i UA për Shkollim Specialistik 01/2023;
8. Për kategorinë II dhe III sipas këtij konkursi aplikanti duhet të ketë kontratë pune valide dhe rekomandim me shkrim nga institucioni kërkues i cili zotohet me shkrim se do ta mbështes financiarisht shkollimin specialistik të aplikantit.

**Dokumentet e nevojshme për të aplikuar për shkollim specialistik:**

1. Diploma e studimeve universitare (niveli bachelor dhe master ose studimet e integruara që përfshijnë këto dy nivele) dhe certifikata e nostrifikimit të Diplomës (për ata që kanë diplomuar jashtë Kosovës) në drejtimet: Mjekësi e Përgjithshme, Stomatologji, Farmaci, Psikologji Klinike;
2. Certifikata e notave me kalkulim të notës mesatare (nëse kjo nuk figuron në Diplomë), ndërsa për kandidatët që kanë përfunduar studimet jashtë Republikës së Kosovës duhet



vërtetim i barasvlerësimit të notës mesatare në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”;

3. Licenca e punës e profesionistit shëndetësor;
4. Certifikata mjekësore e aftësisë psiko-fizike;
5. Kopja e letërnjoftimit;
6. Ekstrakti i lindjes i Republikës së Kosovës;
7. Vërtetim antarësie nga Oda përkatëse të Profesionistëve Shëndetësor;
8. Vërtetim mbi përvojën e punës në fushën profesionale përkatëse, pas momentit të licencimit (ky është një dokument i domosdoshëm; mungesa e tij nënkupton se aplikanti nuk ka përvojë pune);
9. Deklaratë nën betim në lidhje me një specializim paraprak (të filluar, të përfunduar, të ndërperë ose të refuzuar) e plotësuar dhe e nënshkruar personalisht nga aplikanti (mund të shkarkohet në vegzën konkursit);
10. Për kategoritë II dhe III aplikanti duhet të ketë kontratën e punës valide si dhe rekomandim me shkrim (letër mbështetëse) nga institucioni kërkues i cili e rekomandon konform nevojave të veta dhe zotohet me shkrim se do t’ua mbështesë shkollimin specialistik të aplikantit; mungesa këtyre dy dokumenteve është kriter skualifikues për këto kategori!

### **Kriteret e përzgjedhjes së aplikantëve për shkollim specialistik:**

Pikët maksimale që aplikanti mund të grumbulloj janë 100, të shpërndara sipas kriterëve:

#### **Pikë POZITIVE**

1. Nota mesatare: 50/100 pikë (sipas sistemit 5 x nota mesatare)
2. Koha e pritjes nga diplomimi: 10/100 pikë (sipas sistemit 0.5 pikë/vit, deri në maksimumin 10 pikë);
3. Përvoja e punës profesionale në fushën përkatëse ku posedon licencën: 10/100 pikë (sipas sistemit 2 pikë/vit, deri në maksimumin 10 pikë);
4. Studimet postdiplomike të nivelit doktoratës (PhD/Dr sc) ose Magjistraturës shkencore (Mr sc): 10/100 pikë (sipas sistemit doktoraturë/ PhD e përfunduar 10 pikë; Magjistraturë e përfunduar 5).
5. Punimet shkencore: 10/100 pikë (sipas sistemit autor i parë ose korrespondent në punim origjinal/revial/metanalizë të publikuar në revistë me recension ndërkombëtar deri 10 pikë, autor i parë në studim rasti i publikuar në revistë me recension ndërkombëtar 5 pikë, deri në 10 pikë maksimumi; autor i parë ose korrespondent në punim origjinal/revial/metanalizë në revistë vendore ose rajonale me 3 pikë deri në maksimum 6 pikë, autor i parë në studim rasti në revistë vendore ose rajonale me 2 pikë deri në 6 pikë maksimumi; (përfshihen këtu revistat predatorë).
6. Prezentime në konferenca shkencore: 10/100 pikë (sipas sistemit pjesëmarrje aktive në konferencë ndërkombëtare si autor i parë 5 pikë me maksimum 10 pikë, pjesëmarrje aktive në konferenca vendore ose rajonale si autorë i parë 3 pikë (prezentim oral ose poster i moderuar, ose autorë i parë në poster jo të moderuar) me maksimum 6 pike; të gjitha pjesëmarrjet/prezentimet duhet dëshmuar me libër abstrakti.

#### **Pikët NEGATIVE:**

1. Vonesat në afatin e diplomimit: -10/100 pikë (sipas sistemit -0.5 pikë/vit vonesë, deri në minimumin -10 pikë); *përfshihet rasteve të përcaktuara me statutet e IAL, krahas dëshmitë përkatëse si dhe përfshihet këtu viti akademik i studimeve 1998/1999 për ish studentët e UPHP.*
2. Specializimi paraprak: -20/100 pikë, sipas sistemit -20 pikë specializim i përfunduar ose i papërfunduar/pezulluar/ndërprerë (*përfshihen këtu ata të cilët e kanë çregjistruar specializimin dhe kanë kryer obligimet kontraktuale me Ministrinë e Shëndetësisë apo*

*Institucionin Shëndetësor ose ata të cilët këtë e kanë bërë për arsye shëndetësore të dokumentuara me mendim konziliar).*

3. Tërheqja pa arsye nga konkursi paraprak (refuzimi i specializimit të fituar) pas daljes së rezultateve përfundimtare, në fazën e parapare për lidhjen së kontratës: -10/100 pike.

**Vërejtje:**

-gjatë aplikimit fillestar **çdo kandidatë ka të drejtë të për zgjedh vetëm një lëmi specialitike ku dëshiron të aplikoj nga lista e specializimeve të ofruara dhe konform profilit profesional** (që e specifikon shtojca 2 e UA për shkollim specialistik 01/2023);

-kandidatët e papranuar pas shpalljes së rezultateve preleminare nga kategoria e parë sipas këtij konkursi, kanë të drejtë ndrimi të lëmisë nga lëmia paraprakisht në ndonjërin nga lëmitë ku kanë mbetur vende të paplotësuara; kërkesa e tyre deponohet me shkrim në BShS gjatë periudhës nga shpallja e rezultateve preleminare deri në ato përfundimtare; BShS bazuar në kompetencat e veta, do të rikonsideroj këto kërkesa dhe mund t'i riradhisë kandidatët e interesuar në lëminë prioritare me vende të lira, sipas pikëve të grumbulluara fillimisht, për t'i shpallur në rezultatet përfundimtare të konkursit.

**-konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes.**